



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.31/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e vëzhguesit nga subjekti politik Lista Serbe, Dejan Jevtić, e paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZP.Anr.31/2026 e datës 09.06.2026, e parashtruar nga vëzhguesi i subjekti politik Lista Serbe, Dejan Jevtić, kundër Këshillit të Vendvotimit - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Me datën 09.06.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën e vëzhguesit të subjektit politik Lista Serbe, Dejan Jevtić, e paraqitur kundër anëtarit të Këshillit të Vendvotimit - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me të cilën pretendon se me datë 07.06.2026 në Vendvotimin (VV) 1005/1, Strezovce, komuna e Kamenicës, ka pasur parregullësi në lidhje me procedurat e zhvillimit të procesit zgjedhor, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në rregullsinë dhe ligjshmërinë e votimit dhe kanë vënë në pikëpyetje vullnetin e vërtetë të votuesve. Sipas ankesës i njëjti, ka dyshim të bazuar në përshkrimin e shkeljes si në vazhdim: si vëzhgues në vendvotim ka mbërritur rreth orës 14:00. Kur ka mbërritur, kanë qenë të pranishëm katër anëtarë të Këshillit të Vendvotimit (KVV). Rreth orës 14:20, njëri nga anëtarët e KVV-së ishte ulur në tryezën ku ndodheshin fletëvotimet dhe po i vuloste ato (rreth 10 deri 15 fletëvotime) paraprakisht, edhe pse nuk kishte asnjë votues në VV. Më pas, kur anëtarët e tjerë dolën për një pushim të shkurtër për të pirë duhan dhe kafe, i njëjti mbeti i vetëm, grisi fletëvotimet (rreth 10) dhe i futi në pantallona me xhep të madh anash, rreth gjurit, pas së cilës doli dhe shkoi në tualet, ku, sipas gjitha gjasave i ka plotësuar, u kthye në VV dhe kur askush nga anëtarët e VV-së nuk ishte në klasë, i futi në kuti. Pas 40 minutash, ai përsëriti të njëjtin veprim në intervalin kohor nga ora 16:40 deri në 18:00. Kjo mund të verifikohet duke

shikuar kamerat. Po ashtu, ka pasur parregullsi edhe gjatë numërimit. I njëjti kërkon të verifikohet numri i nënshkrimeve dhe fletëvotimeve të lëshuara.

Parashtruesi i ankesës si provë nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 10.06.2026, ka deklaruar se pas shqyrtimit të ankesës ZP.Anr.31/2026 dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj, jep sqarimet/përgjigjet si më poshtë:

Bazuar në nenin 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit përcaktohet në mënyrë të detajuar mbarëvajtja dhe ecuria, obligimet në vendvotim. KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Kamenicës, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: *“KKZ në Kamenicë nuk ka pranuar asnjë ankesë apo shqetësim nga Këshilli i Vendvotimit me numër 1005/01. Për më tepër, kemi komunikuar me Kryesuesin e KVV i cili garanton se një gjë e tillë nuk ka ndodhur në vendvotimin në fjalë.”* Si provë ka bashkangjitur deklaratën e KKZ-së në Kamenicë.

Gjithashtu, ju njoftojmë se lidhur me rastin në fjalë, nuk është raportuar për ndonjë parregullsi në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, më datë 07.06.2026. Gjatë shqyrtimit të ankesës, është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj, të paraqitura në ankesë. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë dhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunës së Kamenicës, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e vëzhguesit të subjektit politik Lista Serbe, Dejan Jevtić, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullsi në qendrën e votimit 1005/1, Strezovce, komuna e Kamenicës dhe se ka pasur keqpërdorim me fletëvotimet nga anëtarët e KVV-së. Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës lidhur pretendimet e tij nuk i ka mbështetur me prova, rrjedhimisht nuk ka ofruar asnjë dëshmi të qartë dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli me asnjë provë nuk ka mundur të konstatoj se ka pasur manipulime në ditën e votimit në qendrën e votimit të komunës së Kamenicës.

Po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-së, është konstatuar se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruara me ankesë sepse nuk është raportuar për ndonjë parregullsi në dhomën operative të KQZ-së, pra nuk ka pasur asnjë ankesë apo shqetësim nga Këshilli i Vendvotimit me numër 1005/01 në ditën e zgjedhjeve, më datë 07.06.2026. Është vlerësim edhe i panelit se

këtu ankuesi si vëzhgues në vendvotimin e caktuar në momentin kur ka vërejtur parregullsinë është dashur që të njoftojë kryesuesin e KVV lidhur me parregullsinë konkrete, e të cilën në rastin konkret nuk e ka bërë, andaj dhe nuk ka mundur të vërtetohet se ka ndodhur shkelja e pretenduar.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë, andaj në mungesë të provave lidhur me shkeljet e pretenduara ankesa si e tillë u deshtë të refuzohet e pa bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZP.Anr.31/2026 më datën 11.06.2026

Kryesues i Panelit

Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.